



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

Ex officio

Rasti Nr. 853/2016

RAPORT ME REKOMANDIME

I

AVOKATIT TË POPULLIT

lidhur me

Kriteret diskriminuese në konkurset për punësim të UP

Për:

Z. Marjan Dema, Rektor

Universiteti i Prishtinës

Z. Shyqiri Bytyqi, Ministër

Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë

Kopje për:

Z. Habit Hajredini, Udhëheqës i Zyrës për Qeverisje të Mirë, Zyra e Kryeministrit

Prishtinë, më 12 shkurt 2018

Qëllimi

Qëllimi i këtij raporti është tërheqja e vërejtjes për nevojën e mbrojtjes nga diskriminimi si dhe trajtimi i barabartë në kriteret e vendosura për vendet e lira të punës të shpallura për rekrutimin e kandidatëve në Universitetin e Prishtinës “Hasana Prishtina” (në tekstin e mëtemëj UP) gjatë vitit 2016 dhe 2017. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit do ta analizojë përputhshmërinë e Rregullores nr. 2/475, të datës 8 shtator 2017, për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UP (në tekstin e mëtejme: Rregullorja) me legjislacionin vendor si dhe instrumentet ndërkombëtare në aspekt të veçantë të mbrojtjes nga diskriminimi.

I. BAZA LIGJORE

Në bazë të nenit 135, paragrafit 3 të Kushtetutës, “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”

Po ashtu, Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 18, paragrafi 1, e definon që Avokati i Popullit midis të tjerash ka edhe këto përgjegjësi:

- “të hetojë shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut dhe veprimet e diskriminimit dhe të angazhohet për eliminimin e tyre” (*pika 1*);
- “të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla” (*pika 2*);
- “të bëjë të njohura të drejtat e njeriut dhe përpjekjet për të luftuar të gjitha format e diskriminimit përmes ngritjes së vetëdijesimit, posaçërisht përmes informimit dhe edukimit edhe me anë të mediave” (*pika 4*);
- “të rekomandoj Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit” (*pika 5*);
- “t’i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta” (*pika 6*);
- “të përgatitë raporte vjetore, periodike dhe të tjera mbi gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit dhe të kryejë hulumtime mbi çështjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit në Republikën e Kosovës” (*pika 8*).

II SIPAS FAKTEVE

Avokati i Popullit në bazë të nenit 16.1 të Ligjit për Avokatin e Popullit, nr. 05/L-019, më 5 dhjetor 2016, ka hapur hetime sipas detyrës zyrtare (*ex officio*) lidhur me kriteret diskriminuese të publikuara në konkurset e UP gjatë vitit 2016 dhe 2017.

1. Sipas informacioneve të marra nga burime të ndryshme, por edhe nga disa takime të mbajtura me përfaqësuesin e UP-së, u bë e njohur se Senati i Universitetit, më 30 shtator 2016, ka shpallur konkurs publik për angazhimin me honorar të personelit në bazë të nevojave të njësive akademike. Megjithatë, një nga kushtet për angazhimin e personelit, që është përcaktuar më saktësisht në nenin 5, parashihet që *“Në Universitetin e Prishtinës nuk do të lejohet rekrutimi/angazhimi i kandidatëve që kanë marrëdhënie të ngushta pune, familjare brenda departamenteve/departamenteve ose programeve”*.
2. Gjithashtu, në konkursin e UP të publikuar më 21 korrik 2016 për angazhimin e personelit akademik me honorar në bazë të nevojave të njësive akademike të UP, është paraparë i njëjti kriter.
3. Në takimet me përfaqësuesin e UP-së gjatë vitit 2016, Avokati i Popullit e ka marrë informatën, se kriteri kontestues është futur në konkurs me qëllim të pengimit të *marrëdhënieve të ngushta të punës dhe familjare, përkatësisht nepotizmit me rastin e punësimit brenda të njëjtit departament/degë apo program në UP*. Në kohën e shpalljes së konkursit UP nuk kishte ndonjë rregullore të brendshme që e rregullonte këtë çështje në bazë të ligjeve në fuqi, por u tha se UP është duke e hartuar Rregulloren për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UP *“Hasan Prishtina”*, e cila do ta përfshijë rregullimin e çështjeve të raporteve të ngushta familjare dhe se i gjithë procesi, në lidhje me nxjerrjen e rregullores së lartpërmendur, do të përfundojë në kohën sa më të shkurtër të mundshme dhe UP do ta informojë Institucionin e Avokatit të Popullit.
4. Në takimin radhës, i cili u mbajt më 24 tetor 2017, përfaqësuesi i UP-së i informoi përfaqësueset e Institucionit të Avokatit të Popullit, se më 8 shtator 2017, UP e miratoi *“Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UP”*. Gjithashtu, është thënë se më 19 shtator 2017, UP ka shpallur konkurs të ri për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm për mbajtjen e ligjëratave dhe ushtrimeve në bazë të nevojave të njësive akademike dhe se i njëjti kusht, si në konkurset e cituara paraprakisht, është paraparë edhe në këtë konkurs, duke u thirrur në Rregulloren e brendshme të procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UP *“Hasan Prishtina”*, në të cilin është paraparë i njëjti kusht në bazë të nenit 7, paragrafit 11, i cili thotë *“Në Universitetin e Prishtinës, nuk do të lejohet rekrutimi/angazhimi i kandidatëve brenda ndonjëres prej strukturave themelore organizative (departament/degë apo program), nëse brenda atyre strukturave të njëjtit kanë në marrëdhënie të rregullt pune apo të angazhuar familjarë të ngushtë (në relacionin prind-fëmijë, vëlla-motër, motër-motër, vëlla-vëlla dhe anasjelltas).”*

III. INSTRUMENTET RELEVANTE LIGJORE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

5. Kushtetuta e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta)

Neni 21 [Parimet e Përgjithshme]

1. *Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës.*

2. Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë.

3. Çdokush e ka për detyrë t'i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve. [...]

Neni 24 [Barazia para Ligjit]

1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.

2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal. [...]

Neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtimit të Profesionit]

1. E drejta e punës garantohej.

2. Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës.

6. Konventa Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (4 nëntor 1950) dhe Protokollit 12 i Konventa për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (në tekstin e mëtejshëm: "Konventa") është dokument ligjor që zbatohet drejtpërdrejt në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ka përparësi në rast të konfliktit midis dispozitave të ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike dhe në pjesën përkatëse (neni 14) thotë:

"Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër."

Neni 1 i Protokollit 12 i Konventës thekson:

Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit

1. *Gëzimi i çdo të drejte të parashikuar me ligj duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër.*
2. *Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1.*

7. Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi

Neni 1

1. *Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i një kornize të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimi në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit*

gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar dhe besimit, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore, shtatëzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër, me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë.

Neni 2

1. Ky ligj zbatohet për të gjitha veprimet apo mosveprimet, të të gjitha institucioneve shtetërore dhe lokale, të personave fizik dhe juridik, të sektorit publik dhe privat, të cilët shkelin, kanë shkelur ose mund të shkelin të drejtat e çdo personi apo personave fizik dhe juridik, në të gjitha fushat e jetës, e posaçërisht që kanë të bëjnë me:

1.1. kushtet për qasje në punësim, vetëpunësim dhe punësimin në profesion, përfshirë këtu kushtet e punësimit, kriteret e përzgjedhjes, pa marrë parasysh aktivitetin në të gjitha nivelet e hierarkisë profesionale, përfshirë avancimet; [...]

Neni 3

1. Parimi i trajtimit të barabartë nënkupton se nuk do të ketë kurrfarë diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë sipas kuptimit të cilëdo nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji.

2. Diskriminim është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë në çfarëdo baze të përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, që ka për qëllim apo efekt të zhvleftësoj ose cenoj njohjen, gëzimin ose ushtrimin, në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga Kushtetuta dhe ligjet tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Neni 8

Të gjitha institucionet duhet të veprojnë në përputhje me parimet e këtij Ligji, gjatë ushtrimit të detyrave të tyre dhe gjatë hartimit të politikave dhe legjislacionit.

Neni 9

1. Avokati i Popullit është Institucion i shtetit, i cili e bën promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut . Avokati i Popullit trajton rastet që kanë të bëjnë me diskriminimin sipas ligjit përkatës për Avokatin e Popullit.

2. Avokati i Popullit ka këto kompetenca:

[...]

2.3. Avokati i Popullit ka autorizim të hetoj ose të veproj mbi ndonjë ankesë të parashtruar ose me vetë-iniciativë (ex-officio) kur ka bazë për të dyshuar se ka ndodhur diskriminimi nga subjektet e sektorit publik.

[...]

2.6. përcjell zbatimin e këtij ligji dhe inicon ndryshimin e dispozitave për zbatimin dhe avancimin e mbrojtjes nga diskriminimi;

8. Ligji i punës, nr. 03/L-212

Neni 5

Ndalimi i të gjitha llojeve të diskriminimit

1. Diskriminimi është i ndaluar në punësim dhe profesion, lidhur me rekrutimin në punësim, [...], kushtet e punësimit [...].

[...]

5. Dispozitat e Ligjit nr. 2004/3 Kundër Diskriminimit, do të zbatohen drejtpërsëdrejti kur është në pyetje marrëdhënia e punës e lidhur në mes të të punësuarit dhe punëdhënësit.

Neni 8

1. Punëdhënësi në sektorin publik, është i obliguar që të shpall konkurs publik sa herë që pranon një punëmarrës dhe themelon një marrëdhënie të punës.

2. Konkursi duhet të jetë i barabartë për të gjithë kandidatët e synuar, pa asnjë lloj diskriminimi, ashtu siç parashihet me këtë ligj dhe aktet tjera në fuqi.

III. ANALIZA JURIDIKE

9. Kushtetuta e Kosovës, si akti më i lartë ligjor, i mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj është në interes të funksionimit të sundimit të ligjit edhe realizimi praktik i tyre. Kushtetuta shprehimisht e përcakton se është detyrë e të gjitha autoriteteve t'i respektojnë të drejtat dhe liritë e të tjerëve, ky parim është imperativ dhe duhet të respektohet nga të gjithë, duke përfshirë edhe institucionet arsimore.

10. Kushtetuta në mënyrë eksplicite garanton barazinë e të gjithë personave para Kushtetutës dhe ligjit, të drejtën e secilit për mbrojtje të barabartë ligjore pa diskriminim dhe ndalon çdo diskriminim në bazë të cilësdo bazë të listuar, por po ashtu shton edhe në bazë të ndonjë statusi tjetër personal që nuk përmendet në mënyrë eksplicite në këtë nen.

11. Garancia kushtetuese për të drejtën në punë dhe e drejta e zgjedhjes së lirë të profesionit e krijojnë obligimin e shtetit për t'i mbrojtur këto të drejta në mënyrë të barabartë për të gjithë pa asnjë kufizim të pajustificuar.

12. Avokati i Popullit thekson se sipas vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) “e drejta për të mos u diskriminuar shkelet, kur shtetet i trajtojnë njerëzit në mënyrë të pabarabartë [...] duke mos dhënë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Në mënyrë që një justifikim i tillë të jetë “objektiv dhe i arsyeshëm”, duhet të kalojë dy hapa: Së pari, duhet të ekzistojë “qëllimi legjitim” për pabarazinë në fjalë dhe së dyti, duhet të ekzistojë një “raport i arsyeshëm i proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe objektivit që synohet të arrihet.”

13. Avokati i Popullit thekson se diskriminimi në fushën e punës është i ndaluar edhe me Ligjin e Punës, kurse me Ligjin ombrellë për mbrojtje nga diskriminimi është krijuar një kornizë gjithëpërfshirëse për mbrojtjen nga diskriminimi, me të cilin ndalohet diskriminimi i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë në punësim në çfarëdo baze, për të gjithë akterët që i kanë shkelur, i shkelin ose mund t'i shkelin të drejtat e secilit person, në

veçanti kur kanë të bëjnë me **kushtet për qasje në punësim, duke përfshirë kushtet e punësimit dhe kriteret e përzgjedhjes.**

14. Avokati i Popullit vë në pah se e drejta për punë garantohet gjithashtu me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare, të cilat janë të zbatueshme drejtpërdrejt në Kosovë dhe kanë përparësi mbi ligjet e Kosovës. Prandaj, detyrimi për ta respektuar këtë të drejtë kërkon shmangien e masave që e pengojnë ose parandalojnë gëzimin e të drejtës për punësim dhe përfshijnë respektimin e parimit të barazisë në procedurat për aplikimin për punësim pa kriteret që janë diskriminuese.

IV MENDIMI I AVOKATIT TË POPULLIT

15. Avokati i Popullit thekson se me nocionin e të drejtës për punë dhe zgjedhjes së lirë të profesionit, nënkuptohen të drejtat e barabarta në kushte të barabarta, që do të thotë që për secilin në kushte të barabarta është i qasshëm çdo vend i punës, me çka përjashtohet çdo formë e diskriminimit. Ndalimi i punësimit në bazë të raporteve të ngushta familjare në sektorin publik është në kundërshtim me të drejtën për punë dhe paraqet diskriminim.
16. Avokati i Popullit në mënyrë specifike e kupton problemin e nepotizmit si një formë e veçantë e konfliktit të interesit, që është jashtëzakonisht i shpeshtë me rastin e punësimit në sektorin publik. Megjithatë, shtypja e nepotizmit nuk e nënkupton përjashtimin e plotë të të afërmeve, por e nënkupton ndalimin e keqpërdorimit të pozitës së nëpunësve civilë për të siguruar punë për anëtarët e familjes. Qëllimi nuk është t'i pengojë anëtarët e familjes të punojnë së bashku, por ta parandalojë mundësinë që një nëpunës civil të jetë i njëanshëm, ta favorizojë ose shfrytëzojë ndikimin dhe pozitën e tij për anëtarët e familjes në ushtrimin e kompetencave diskrete për të punësuar nëpunës civilë të kualifikuar.
17. Avokati i Popullit e konsideron se qëllimi i konkursit publik reflektohet në parimin e qasjes së barabartë të të gjithë qytetarëve që nën kushte të njëjta të aplikojnë në mënyrë të barabartë për çdo vend pune në sektorin publik. Barazia në punësim është kusht bazë i barazisë para ligjit. Prandaj, një person për shkak të disa prej karakteristikave të tij personale, ose në rastin konkret, raporteve të ngushta familjare si dhe raporteve të punës që kanë brenda departamentit ose programit të UP-së, nuk mund të privohet nga e drejta për punësim, e cila për të tjerët është e qasshme dhe u njihet në masë të plotë, sepse me këtë ky person vihet në pozitë e pafavorshme, krahasuar me kandidatët e tjerë dhe të njëjtit nuk i lejohet në kushte të barabarta të konkursit të marrë pjesë në garë gjatë procedurës së rekrutimit, por është e rëndësishme të theksohet se në raste të tilla procedura e rekrutimit kërkon transparencë të plotë. Prandaj, punësimi dhe avancimi në UP duhet të bëhet për të gjithë në kushte të barabarta, duke e respektuar plotësisht parimin kushtetues të barazisë dhe qasjen e barabartë në shërbimet publike.
18. Avokati i Popullit e konsideron se si kusht i vetëm për punësim në konkurse duhet caktuar kualifikimet e kërkuara më të mira dhe të përshtatshme, aftësitë e punës të kandidatit që aplikon për punë, ndërsa në asnjë mënyrë kandidati i cili është në marrëdhënie familjare, martesore ose të ngjashme me ndonjë nga punonjësit e UP-së dhe njësitëve përbërës të tij nuk guxon të ketë trajtim preferencial, por as nuk guxon të vihet në pozitë më të pafavorshme me rastin e punësimit ose avancimit.

19. Avokati i Popullit vë në pah se ai në asnjë mënyrë nuk i mbështet punësimet e familjarëve të ngushtë në UP, por ky lloj punësimi as nuk duhet të kufizohet, duhet të lejohet përmes procedurave transparente, duke i përmbushur kriteret ligjore të konkursit dhe me kufizime të ndërlydhura me atë se cilët anëtarë të bashkësive akademike mund të nxjerrin ose marrin pjesë në marrjen e vendimeve për pranimin e kandidatëve në marrëdhënie pune dhe vendimet e tilla duhet të jenë në përputhje me interesin publik dhe integritetin e institucionit.
20. Në rast të dyshimit se ekziston konflikti i interesit në bazë të raporteve të ngushta familjare me rastin e punësimit, në secilin rast individual UP, duhet të jetë në dispozicion një mekanizëm ligjor i bazuar në Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

V. KONKLuzionet e Avokatit të Popullit

21. Avokati i Popullit, pas një analize ligjore të kushtit kontestues të sipërpërmendur në konkursin e UP, të shpallur në vitin 2016 dhe 2017, i cili nuk e lejon paraqitjen në konkurs dhe rekrutimin e kandidatëve brenda të njëjtit departament në bazë të raporteve të ngushta familjare, si dhe nenit 7 paragrafit 11 të Rregullores së brendshme të procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UP "Hasan Prishtina", të datës 8 shtator 2017, i cili thotë *“Në Universitetin e Prishtinës, nuk do të lejohet rekrutimi/angazhimi i kandidatëve brenda ndonjëres prej strukturave themelore organizative (departament/degë apo program), nëse brenda atyre strukturave të njëjtit kanë në marrëdhënie të rregullt pune apo të angazhuar familjarë të ngushtë (në relacionin prind-fëmijë, vëlla-motër, motër-motër, vëlla-vëlla dhe anasjelltas), konkludon, se në kontekstin e parimit të barazisë, paraqet kusht diskriminues dhe është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.*
22. Avokati i Popullit konstaton se mbrojtja e të drejtave të plota të punësimit nënkupton zbatimin e plotë të parimit të kapacitetit profesional dhe ofrimin e të drejtës së pjesëmarrjes në një konkurrencë të hapur në procesin e rekrutimit, të gjithë kandidatëve të interesuar duke mos e shkelur procedurën e përgjithshme dhe kushtet e përgjithshme për punësim në institucionet publike, në mënyrën në të cilën të gjithë kandidatëve, pa përjashtim, në kushte të barabarta u bëhen të qasshme të gjitha vendet e punës në UP.

Duke u bazuar në këto gjetje dhe në përputhje me nenin 135, paragrafin 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 16, paragrafin 4 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit,

Avokati i Popullit rekomandon:

- 1. Që UP në konkurset për punësim, në të ardhmen, të mos e përsëritë kushtin kontestues, i cili nuk e lejon paraqitjen në konkurs dhe rekrutimin e kandidatëve brenda departamentit të njëjtë, në bazë marrëdhënies të ngushta familjare.***

2. *Që UP ta fshijë nenin 7 paragrafin 11 të Rregullores së brendshme të procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UP “Hasan Prishtina”, nr 2/475 , të datës 8 shtator 2017.*
3. *Që UP, në përputhje me rregulloret ligjore në fuqi, me rregullore të veçantë të rregullojë më saktësisht praktikën e papranueshme të punësimit, si dhe çështjet e tjera që ndërlidhen me parandalimin e nepotizmit në UP.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafin 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.”) dhe nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.”), mirësisht Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,

Hilmi Jashari

Avokat i Popullit